

VENDIM
NR. 78, datë 16.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESËN MINIMALE
PËR INSTRUMENTET E KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIMET
E PRANUARA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 32, pika 5, si dhe nenit 87, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Rregullorja “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” hyn në fuqi në datën 30 tetor 2021.

3. Ngarkohen Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR KËRKESËN MINIMALE PËR INSTRUMENTET E KAPITALIT
RREGULLATOR DHE DETYRIMET E PRANUARA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar për çdo bankë.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në zbatim të:

- a) nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”;
- c) nenit 87 të ligjit nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose të përdorur në:

- a) ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në vijim “Ligji për bankat”;
- c) ligjin nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, në vijim “Ligji nr. 133/2016”;
- d) ligjin nr. 62/2020, datë 14.5.2020, “Për tregjet e kapitalit”, në vijim ligji “Për tregjet e kapitalit”;
- e) rregulloren nr. 69, datë 18.12.2014, “Për kapitalin rregullator”, të ndryshuar, në vijim rregullore “Për kapitalin rregullator”;
- f) rregulloren nr. 41, datë 5.6.2019, “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” në vijim rregullore “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”;
- g) rregulloren nr. 48/2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të ndryshuar, në vijim rregullore “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;
- h) rregulloren nr. 31/2018, “Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, të ndryshuar, në vijim rregullore “Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

KREU II

KËRKESA MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIME TË PRANUARA

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

1. Në zbatim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 133/2016, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton “kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” për secilën bankë në bazë individuale dhe/ose në nivel të konsoliduar, sipas njoftimit që i bëhet bankës për këtë qëllim.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përllogarit “kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”, në përputhje me nenet 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

a) nevojën për të siguruar zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë, duke përfshirë atje ku është e përshtatshme, instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, me synim përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) nevojën për të siguruar, sipas rastit, që banka zotëron instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, në nivelin që mundëson përthithjen e humbjeve dhe rivendosjen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në masën që siguron vazhdimësinë

e kryerjes së veprimtarive për të cilat banka është licencuar sipas ligjit për bankat, në rast se zbatohet instrumenti i rikapitalizimit nga brenda ose ushtrohen kompetencat e zhvlerësimit dhe konvertimit;

c) nevojën për të garantuar që nëse plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon përjashtimin plotësisht ose pjesërisht të disa detyrimeve të caktuara nga rikapitalizimi nga brenda në përputhje me pikën 4, të nenit 31, të ligjit nr. 133/2016, ose transferim të detyrimeve të caktuara nga banka te një marrës nëpërmjet një transferimi të pjesshëm, banka ka mjaftueshëm instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të tjera të pranuar për përthithjen e humbjeve dhe rivendosjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e nevojshëm për vazhdimësinë e kryerjes së veprimtarive për të cilat banka është licencuar në përputhje me ligjin për bankat;

d) madhësinë, modelin e biznesit, modelin e financimit dhe profilin e rrezikut të bankës;

e) shkallën në të cilën, paaftësia paguese e bankës mund të ketë efekte të dëmshme në stabilitetin financiar, nëpërmjet efektit zinxhir, për shkak të ndërlidhjes me bankat e tjera ose me pjesën tjetër të sistemit financiar.

3. Në rast se plani për ndërhyrjen e jashtëzakonshme parashikon vendosje të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose ushtrim të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit, në përputhje me nenin 45, të ligjit nr. 133/2016, kërkesa sipas pikës 1, neni 32, të ligjit nr. 133/2016, duhet të jetë të paktën sa shuma e:

a) vlerës së nevojshme për përthithjen e humbjeve nga banka, të përlllogaritur sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje; dhe

b) vlerës së nevojshme për rikapitalizimin e bankës në nivelin që mundëson përmbushjen e kushteve për licencim dhe kryerjen e veprimtarive në përputhje me ligjin për bankat, për një periudhë të përshtatshme deri në një vit, të përlllogaritur sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

4. Në rast se plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon likuidimin e bankës, sipas procedurave të likuidimit të detyruar, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse kërkesa, sipas pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 133/2016, për këtë bankë, nuk duhet të tejkalojë shumën e mjaftueshme për përthithjen e humbjeve që mund të ketë banka, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme identifikon detyrime që mund të përjashtohen pjesërisht ose plotësisht nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda sipas pikës 4, neni 31, të ligjit nr. 133/2016, ose mund të transferohen plotësisht te një marrës, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kërkon që kërkesa minimale e përcaktuar, sipas këtij neni të plotësohet me kapital rregullator dhe detyrime të pranuar të mjaftueshme, për:

a) mbulimin e vlerës së detyrimeve të përjashtuara të identifikuar, sipas nenit 31, pika 4, të ligjit nr. 133/2016;

b) plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

6. Administratori përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme merr vendimin mbi “kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar”. Ky vendim komunikohet në formë shkresore, sipas dispozitave të nenit 6, shkronja “d”, të rregullores “Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme” dhe përfshin:

a) përlllogaritjet sipas neneve 6 dhe nenit 7 të kësaj rregulloreje;

b) vlerën totale për “kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, që përlllogaritet si vlera e nevojshme për përthithjen e humbjeve (e përcaktuar sipas nenit 6, pika 2, në këtë rregullore) plus dhe vlerën e nevojshme për rikapitalizim (e përcaktuar sipas nenit 7, pika 4, në këtë rregullore);

c) raportin e vlerës totale për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, të shprehur si:

- i. përqindje të të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës, të përlogaritur sipas nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 133/2016;
- ii. përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, të përlogaritur sipas nenit 6, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

Neni 6

Vlera e nevojshme për përthithjen e humbjeve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton vlerën e nevojshme për përthithjen e humbjeve, duke marrë në konsideratë kërkesat për kapital të zbatueshme për bankën, si në vijim:

a) kërkesat për kapital në zbatim të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, ku përfshihet:

i. raporti prej 6.75% i kapitalit bazë të nivelit të parë, ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

ii. raporti prej 9% i kapitalit të nivelit të parë, ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

iii. raporti prej 12% i kapitalit rregullator, ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun (raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit);

b) kërkesën për kapital shtesë të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës.

2. Vlera për përthithjen e humbjeve e përcaktuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është shuma e kërkesave të referuara në nënpikën “iii” të shkronjës “a” dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, që përlogaritet si në vijim:

Vlera për përthithjen e humbjeve = Ekspozimet e ponderuara me rrezik

**(norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (12%) + norma shtesë për kapital (%))*

Neni 7

Vlera e nevojshme për rikapitalizim

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton vlerën për rikapitalizim të bankës, që nevojitet për zbatimin e strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas përcaktimit në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Vlera e rikapitalizimit është të paktën e barasvlershme me shumën e nevojshme për përmbushjen e kërkesave për kapital, në masën që siguron vazhdimësinë e kryerjes së veprimtarive për të cilat banka është licencuar, sipas ligjit për bankat, pas zbatimit të strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton vlerën e nevojshme për rikapitalizim, duke marrë në konsideratë kërkesat për kapital të zbatueshme për bankën, si në vijim:

a) kërkesat për kapital në zbatim të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankave”, ku përfshihet:

i. raporti prej 6.75% i kapitalit bazë të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

ii. raporti prej 9% i kapitalit të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

iii. raporti prej 12% i kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun (raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit);

b) kërkesën për kapital shtesë të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës.

4. Vlera e rikapitalizimit e përcaktuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është shuma e kërkesave të referuara në nënpikën “iii”, të shkronjës “a”, dhe në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni, që përlogaritet si në vijim:

*Vlera e nevojshme për rikapitalizim = Ekspozimet e ponderuara me rrezik
(Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (12%) + norma shtesë për kapital (%))

5. Në përcaktimin e vlerës së rikapitalizimit, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme:

a) përdor vlerën më të fundit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik të raportuar, për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të korrigjuar për ndryshime të mundshme në këtë vlerë nga veprimet që parashikohen në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) pas konsultimit me Autoritetin Mbikëqyrës, në lidhje me modelin e biznesit, modelin e financimit dhe profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës, mund të përcaktojë një vlerë më të lartë ose më të ulët të nevojës për kapital shtesë që duhet të mbajë banka pas zbatimit të strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas pikës 3, shkronja “b” në këtë nen.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të përcaktojë një nivel më të lartë të kërkesës për kapital shtesë, sipas pikës 5, shkronja “b”, në këtë nen, nëse e konsideron të nevojshme për ruajtjen e besimit të tregut pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë ose ushtrimit të kompetencave të konvertimit dhe të zhvlerësimit, për një periudhë të përshtatshme, deri në një vit.

7. Në rast të zbatimit të pikës 6 të këtij neni, vlera shtesë për ruajtjen e besimit të tregut përlllogaritet si diferenca ndërmjet shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit të përcaktuar, sipas nenit 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” dhe kërkesës specifike kundërciklike të kapitalit të përcaktuar në shkronjën “a”, pika 6, të nenit 11, në të njëjtën rregullore.

8. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të përcaktojë një nivel më të ulët të kërkesës për kapital shtesë, sipas pikës 5, shkronja “b”, në këtë nen, nëse pas konsultimit me Autoritetin Mbikëqyrës, konsideron se një nivel më i ulët do të ishte i mjaftueshëm për të siguruar besimin në treg dhe për të garantuar vazhdimësinë e funksioneve me rëndësi kritike të bankës, si dhe aksesin e saj në financim, pa mbështetje financiare të jashtëzakonshme, përveç kontributit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përputhje me pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 133/2016, dhe me kërkesat që rregullojnë përdorimin e tij, të përcaktuara në pikën 6, të nenit 31, të këtij ligji.

KREU III DETYRIMET E PRANUARA

Neni 8

Përbërja e instrumenteve të detyrimeve të pranuar

1. Detyrimet e pranuar përbëhen nga instrumentet e mëposhtme, përveç rasteve kur përfshihen në kategoritë e përjashtuara, sipas pikës 2 të këtij neni dhe në atë masë kur përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 10 në këtë rregullore:

a) instrumente të detyrimeve të pranuar, që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 9, në atë masë që nuk klasifikohen si zëra/elemente të kapitalit bazë të nivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të kapitalit të nivelit të dytë;

b) instrumente të kapitalit të nivelit të dytë me maturimin e mbetur më të gjatë se një vit, në atë masë që nuk klasifikohen si zëra/elemente të kapitalit të nivelit të dytë, në përputhje me rregulloren “Për kapitalin rregullator”.

2. Detyrimet e mëposhtme përjashtohen nga zërat e detyrimeve të pranuar për qëllime të plotësimit të “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”:

a) detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” deri në “f”, të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 133/2016;

b) llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me afat maturimi fillestar më pak se një vit;

c) pjesa e depozitave të siguroeshme të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare, e cila tejkalon nivelin maksimal të mbulimit nga skema e sigurimit të depozitave, sipas nenit 121, pika 1, shkronja “ç”, e ligjit për bankat;

d) detyrimet që lindin nga instrumentet e borxhit me karakteristika derivative.

3. Për qëllimet e shkronjës “d”, të pikës 2, instrumentet e borxhit që përmbajnë opsionet e ripagesës së hershme, të ushtruar sipas gjykimit të emetuesit dhe instrumentet e borxhit me interesa të ndryshueshëm, që rrjedhin nga një normë reference e përdorur gjerësisht në tregun vendës ose ndërkombëtar, nuk do të konsiderohen si instrumente borxhi me karakteristika derivative, vetëm për shkak të këtyre karakteristikave.

Neni 9

Kushtet për njohjen e instrumenteve për përmbushjen e “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

1. Instrumenti klasifikohet si detyrim i pranuar vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në vijim dhe ato të përcaktuara në nenin 10:

a) instrumenti është i emetuar nga banka dhe është plotësisht i paguar;

b) instrumenti nuk është blerë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe nuk është financuar nga asnjë prej subjekteve të mëposhtme:

i. banka apo subjekte të grupit bankar;

ii. subjekte në të cilat banka zotëron, në mënyrë direkte ose me anë të kontrollit, 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të tyre;

c) për instrumentet e emetuara pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pretendimi mbi kryegjënë është plotësisht i nënrenditur ndaj kërkesave, që rrjedhin nga detyrimet e përjashtuara në shkronjat “a” deri në “f”, të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 133/2016. Nënrenditja në këtë pikë konsiderohet se përmbushet nëse dispozitat kontraktuese që rregullojnë instrumentin, specifikojnë se në rast të likuidimit të detyruar, pretendimi mbi kryegjënë e instrumentit renditet poshtë kërkesave, që rrjedhin nga secili prej detyrimeve të përjashtuara, sipas pikës 2, neni 31, të ligjit nr. 133/2016;

d) instrumenti nuk është subjekt i garancisë ose i ndonjë marrëveshjeje tjetër që përmirëson përparësinë e shlyerjes së pretendimeve ndaj kreditorëve të bankës, nga secili prej subjekteve të mëposhtme:

i. banka ose filialet e saj;

ii. banka mëmë dhe filialet e tjera të saj;

iii. shoqëria *holding* financiare mëmë ose filialet e saj;

iv. shoqëria *holding* me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj;

v. shoqëria *holding* financiare me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj;

vi. subjektet palë të lidhura me subjektet e përcaktuara në nënpikat më sipër (i deri në v);

e) instrumenti nuk është subjekt i marrëveshjeve të vendosura ose marrëveshjeve të kompensimit (*netting*) që dëmton kapacitetin e tij për përthithjen e humbjeve në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

f) dispozitat e kontratës së instrumentit nuk përfshijnë asnjë nxitje (*incentivë*) për të paguar përmes opsionit të thirrjes (*call*) ose për të shlyer para afatit të maturimit, shumë e kryegjësë nga banka, me përjashtim të përcaktimit në pikën 2, të nenit 10, të kësaj rregulloreje;

g) instrumenti nuk mund të ekzekutohet/shlyhet ose paguhet më herët se data e maturimit nga zotëruesi i instrumentit, me përjashtim të përcaktimit në pikën 3, të nenit 10, të kësaj rregulloreje;

h) kur instrumenti përfshin një ose më shumë opsione të thirrjes (*call*) ose opsione të ripagesës së hershme, këto opsione mund të ushtrohen vetëm me diskrecion të emetuesit (bankës), me përjashtim të përcaktimit në pikën 2, të nenit 10, të kësaj rregulloreje;

i) instrumenti mund të ekzekutohet, ripaguhet ose shlyhet nga banka kur janë plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 12 të kësaj rregulloreje;

j) dispozitat e kontratës së instrumentit nuk specifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që instrumenti mund të ekzekutohet/shlyhet ose paguhet më herët nga banka, me përjashtim të rastit të likuidimit vullnetar apo likuidimit të detyruar bankës;

k) dispozitat e kontratës së instrumentit nuk i japin të drejtën zotëruesit të përshpejtojë planin e pagesave të interesave dhe të kryegjësë në të ardhmen, përveç rastit të paafësisë paguese ose likuidimit të bankës;

l) niveli i pagesës së interesit ose i dividendit për instrumentit nuk ndryshon në bazë të cilësisë së bankës apo të bankës mëmë;

m) për instrumentet e emetuara pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, dokumentacioni përkatës kontraktual dhe prospekti në lidhje me emetimin e këtij instrumenti, i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimit të mundshëm të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit dhe në përputhje me nenin 45, të ligjit nr. 133/2016;

n) për instrumentet e emetuara pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, dokumentacioni përkatës kontraktual dhe prospekti në lidhje me emetimin e këtij instrumenti, është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsultohet me Autoritetin Mbikëqyrës për vlerësimin e plotësimit të kushteve në këtë nen.

3. Në rast se kushtet e aplikueshme të përcaktuara në këtë nen pushojnë së ekzistuari, detyrimi pushon menjëherë së klasifikuari si instrument i detyrimeve të pranuar.

4. Në zbatim të kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bankat paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm, si pjesë të kërkesës për klasifikimin e instrumenteve si detyrim i pranuar:

a) dokumentacioni bazë (kontratë, prospekt etj.) i lidhur me emetimin e këtyre instrumenteve;

b) një ilustrim skematik të plotësimit të tipareve/kushteve të kërkuara për të tilla instrumente, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duke dhënë referencat përkatëse në dokumentacionin bazë sipas shkronjës “a” të kësaj pike;

c) një përshkrim i trajtimeve kontabël të instrumenteve në fjalë, së bashku me një opinion nga një ekspert kontabël i autorizuar, në lidhje me pranueshmërinë e tyre.

5. Administratori përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme merr vendimin për klasifikimin e instrumenteve si detyrim i pranuar dhe ia komunikon me shkrim bankës.

Neni 10

Amortizimi i maturitetit të instrumenteve të detyrimeve të pranuar për qëllime të përmbushjes së “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

1. Instrumenti i detyrimit të pranuar me maturitet të mbetur prej të paktën një viti klasifikohet plotësisht si i pranuar, ndërsa instrumenti me një maturitet të mbetur nën një vit nuk klasifikohet si i tillë.

2. Për qëllimet e pikës 1, në rast se instrumenti i detyrimit të pranuar përfshin një nxitje (incentivë) për kreditorin, që mund të ushtrojë opsionin e thirrjes (*call*) ose të

kërkojë të shlyejë instrumentin përpara maturimit fillestar të tij, maturim i instrumentit përcaktohet data më e hershme e mundshme në të cilën ai mund ta ushtrojë atë opSION, sipas vlerësimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

3. Për qëllimet e pikës 1, në rast se instrumenti i detyrimit të pranuar përfshin një nxitje (incentivë) për emetuesin (bankën), që mund të ushtrojë opSIONIN (*call*) ose të kërkojë të shlyejë instrumentin përpara maturimit fillestar të tij, maturim i instrumentit përcaktohet data më e hershme e mundshme në të cilën ai mund ta ushtrojë atë opSION, sipas vlerësimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Neni 11

Kushtet për njohjen e instrumenteve që zotërohen nga klientë joprofesionistë, për qëllime të përmbushjes së “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

1. Për qëllime të përmbushjes së “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar”, banka mund të përdorë instrumente të detyrimeve të pranuar që zotërohen nga klientët joprofesionistë, të kategorizuar sipas nenit 62, të ligjit “Për tregjet e kapitalit”, vetëm kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) banka ka kryer testin e përshtatshmërisë, sipas dispozitave të ligjit “Për tregjet e kapitalit”;

b) banka përcakton se, në bazë të testit të kryer sipas shkronjës “a”, instrumenti është i përshtatshëm për klientin joprofesionist;

c) banka dokumenton kryerjen e testit të përshtatshmërisë sipas dispozitave të ligjit “Për tregjet e kapitalit”.

2. Dispozitat e pikës 1 të këtij neni zbatohen për instrumentet e emetuara pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Instrumentet e detyrimeve të pranuar që zotërohen nga klientët joprofesionistë, që përmbushin kërkesat në këtë nen, duhet të përmbajnë dispozita kontraktore detyruese me anë të së cilave kreditorët bien dakord që të pranojnë çdo zvogëlim të kryegjësë apo të shumës së disbursuar e të papaguar, si dhe çdo konvertim apo anulim që kryhet gjatë ushtrimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, të kompetencave të zhvlerësimit dhe të konvertimit, sipas nenit 45, të ligjit nr. 133/2016.

Neni 12

Miratimi paraprak për zvogëlimin e detyrimeve të pranuar

1. Banka merr miratimin paraprak të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për të zvogëluar, për të shlyer ose për të ushtruar opSIONIN e thirrjes (*call*) përpara datës së maturimit, për instrumentet e detyrimeve të pranuar, të cilat nuk përfshihen në instrumentet e përcaktuara në nenin 38 të rregullores “Për kapitalin rregullator”.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme jep miratimin paraprak për të zvogëluar, për të shlyer ose për të ushtruar opSIONIN e thirrjes (*call*) së instrumenteve të detyrimeve të pranuar të përcaktuara në pikën 1, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) banka i zëvendëson në të njëjtën kohë ose më herët instrumentet e cituara në pikën 1, me instrumente të kapitalit rregullator ose instrumente të detyrimeve të pranuar me një cilësi të njëjtë ose më të lartë, me kusht që këto instrumente të jenë të qëndrueshme për kapacitetin e të ardhurave të bankës;

b) banka vërteton se pas kryerjes së këtij veprimi, vlera “e instrumenteve të kapitalit rregullator dhe e detyrimeve të pranuar” nuk do të bjerë nën kufijtë minimalë të

përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë dhe një shtesë që Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme e konsideron të nevojshme.

3. Kur banka ofron garanci të mjaftueshme që përmbush kërkesat e pikës 2 në këtë nen, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pas konsultimit me Autoritetin Mbikëqyrës, mund të japë miratimin paraprak që banka të zvogëlojë, të shlyejë ose të ushtrojë opsionin e thirrjes (*call*) së instrumenteve të detyrimeve të pranuar, sipas kritereve që sigurojnë që çdo veprim i tillë i ardhshëm do të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 2.

4. Miratimi paraprak i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni jepet vetëm për një periudhë të caktuar kohore, jo më e gjatë se një vit, periudhë që mund të rinovohet. Ky miratim jepet vetëm për shumën të paracaktuara, të cilat përcaktohen nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të shfuqizojë miratimin paraprak, në rast se banka shkel ndonjë nga kushtet e parashikuara për qëllimet e këtij miratimi.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme komunikon me shkrim miratimin paraprak, në lidhje me zvogëlimin e detyrimeve të pranuar, përmes Administratorit përgjegjës për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Neni 13

Përmbushja e “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

1. “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” përmbushet nga instrumente të kapitalit rregullator dhe instrumente të detyrimeve të pranuar, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 8–10 të kësaj rregulloreje.

2. Për qëllime të pikës 1, banka mund të përdorë instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe instrumente të kapitalit të nivelit të dytë, si dhe detyrime të pranuar në vlerën që mbetet, pasi secili prej tyre pakësohet me shumën që nevojitet për të përmbushur:

a) kërkesat e përcaktuara në rregulloren “Për kapitalin rregullator”;

b) kërkesën për kapital shtesë të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës.

3. Kur “kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” përmbushet nëpërmjet instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë, kryhet përpara përmbushjes së kërkesës për shtesat makroprudenciale të kapitalit të përcaktuar në nenin 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zhvillon dhe përditëson në mënyrë të rregullt metodologjitë dhe politikat e posaçme, në lidhje me mënyrën e përmbushjes së “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” dhe i publikon ato.

Neni 14

Masat korrektuese

1. Banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Autoritetit Mbikëqyrës, në rast se ndodhet në kushtet e mosplotësimit të “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

2. Në vijim të njoftimit, sipas pikës 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ndërmerr të paktën një nga masat e mëposhtme:

a) ushtron kompetencat për trajtimin ose heqjen e pengesave ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 133/2016;

b) ushtron kompetencat për kufizimin e pagesës së shpërndarjes, për qëllime të “kërkesës për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, sipas përcaktimit në nenin 15 të kësaj rregulloreje;

c) kërkon aktivizimin e ndërhyrjes së hershme, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 133/2016;

d) vendos sanksione, në përputhje me nenin 80 dhe nenin 81 të ligjit nr. 133/2016;

e) kërkon që banka të paraqesë një plan për përmbushjen e nivelit të instrumenteve të kapitalit rregullator dhe të detyrimeve të pranuar, që synon të rikthejë:

i. përputhshmërinë me kërkesën minimale të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe sipas rastit;

ii. përputhshmërinë e njëkohshme të kërkesës minimale të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe të kërkesës së përcaktuar në nenin 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”;

f) kërkon që banka të emetojë detyrime të pranuar, që plotësojnë kërkesën minimale të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje;

g) kërkon që banka të ndërmarrë hapa të tjerë për përmbushjen e “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë në veçanti përpjekjen për të rinegociuar çdo detyrim të pranuar, instrument të kapitalit shtesë të nivelit të parë ose instrument të kapitalit të nivelit të dytë të emtuar prej saj, që synon garantimin se çdo vendim i Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për zhvlerësimin apo konvertimin e atij detyrimi ose instrumenti mund të zbatohet sipas ligjit të juridiksionit që rregullon atë detyrim ose instrument; dhe

h) kërkon që banka të ndryshojë profilin e maturimit:

i. të instrumenteve të kapitalit rregullator, pas marrjes së miratimit nga Autoriteti Mbikëqyrës, dhe

ii. të detyrimeve të pranuar të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

3. Përveç masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në rast të mosplotësimit të “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, Banka e Shqipërisë në ushtrimin e mandatit si Autoritet Mbikëqyrës dhe Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, mund të kryejë edhe vlerësimin, nëse banka konsiderohet të jetë pranë një situatë të paaftësisë paguese, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 133/2016.

4. Në rast se Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kompetencën për trajtimin ose heqjen e pengesave ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, banka i propozon autoritetit masat e mundshme që do të ndërmarrë dhe afatin kohor të zbatimit të tyre, në mënyrë që të sigurojë plotësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe kërkesës për shtesën e kombinuar të kapitalit të përcaktuar në nenin 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, ku pengesë thelbësore për aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme është njëra prej situatave të mëposhtme:

a) banka plotëson kërkesën e shtesës së kombinuar të kapitalit të përcaktuar në nenin 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, kur konsiderohet në shtesë të secilës prej kërkesave për kapital në zbatim të rregullores “Për kapitalin rregullator” dhe kërkesës shtesë për kapital të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës, por nuk e plotëson kërkesën e shtesës së kombinuar të kapitalit të përcaktuar në nenin 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, kur konsiderohet në shtesë edhe të kërkesave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje; ose

b) banka nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

5. Afati kohor për zbatimin e masave të propozuara në pikën 4 të këtij neni, merr në konsideratë arsyet e pengesës thelbësore. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, konsultohet me Autoritetin Mbikëqyrës, për të vlerësuar nëse masat e propozuara nga banka adresojnë ose largojnë në mënyrë efektive pengesën thelbësore në fjalë.

6. Me përjashtim të pikës 2, shkronja “a”, të këtij neni, vendimmarrja e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi masat korrektuese të përcaktuara në këtë nen komunikohet me shkrim nga Administratori Përgjegjës për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Neni 15

Kompetencat për kufizimin e pagesës së shpërndarjes

1. Në rast se banka përmbush kërkesën për shtesat makroprudenciale të përcaktuara në nenin 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, kur konsiderohen në shtesë të secilës prej kërkesave për kapital në zbatim të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankave” dhe kërkesës për kapital shtesë të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës, por nuk përmbush kërkesën për shtesat makroprudenciale, kur konsiderohen në shtesë të kërkesës së përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përputhje me pikat 3 dhe 4 të këtij neni, ka kompetencën të kufizojë bankën nga kryerja e pagesave të shpërndarjes përtej nivelit maksimal të përlllogaritur, sipas pikës 7, për secilin prej veprimeve të mëposhtme:

- a) kryerjen e pagesës së shpërndarjes, në lidhje me kapitalin bazë të nivelit të parë;
- b) krijimin e një detyrimi për pagimin e shpërblimeve ose përfitime të ndryshueshme të fondit të pensionit për drejtuesit e bankës dhe personelin ose për të paguar shpërblimin e ndryshueshëm, nëse detyrimi për të paguar ka lindur në momentin kur banka nuk plotësonte kërkesën për shtesat makroprudenciale të kapitalit;
- c) kryerjen e pagesës së shpërndarjes, në lidhje me instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë.

2. Banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Autoritetit Mbikëqyrës, në rast se ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rast se banka ndodhet në kushtet e pikës 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pas konsultimit me Autoritetin Mbikëqyrës, vlerëson nëse do të ushtrojë kompetencat e përcaktuara në pikën 1, duke marrë në konsideratë elementet e mëposhtme:

- a) arsyen, kohëzgjatjen dhe madhësinë e mospërmbushjes së kërkesave rregullore të përcaktuara në pikën 1, si dhe ndikimin përkatës në mundësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme;
- b) zhvillimet në situatën financiare të bankës, si dhe mundësinë që të përmbushë në të ardhmen e afërt kushtet e përcaktuara në nenin 21, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 133/2016;
- c) mundësinë që banka të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 brenda një kohe të arsyeshme;
- d) në rast se banka nuk mund të zëvendësojë detyrimet, të cilat nuk i plotësojnë më kriteret e përcaktuara në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, vlerëson nëse kjo situatë është e përqëndruar në bankë apo vjen për shkak të trazirave në treg;
- e) nëse ushtrimi i kompetencës, sipas pikës 1 të këtij neni, është i përshtatshëm dhe proporcional për adresimin e situatës në të cilën ndodhet banka, duke marrë në konsideratë ndikimin potencial në situatën financiare të bankës dhe në aftësinë e bankës për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përsërit të paktën çdo muaj vlerësimin mbi ushtrimin e kompetencës në pikën 1, për atë kohë sa banka ndodhet në kushtet e pikës 1.

5. Në rast se nëntë muaj pas njoftimit të marrë nga banka, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme pas konsultimit me Autoritetin Mbikëqyrës vlerëson se banka është ende në kushtet e referuara në pikën 1 të këtij neni, ushtron kompetencën e referuar në atë pikë, përveçse kur vlerëson se janë plotësuar të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:

a) situata është krijuar për shkak të problemeve serioze në funksionimin e tregjeve financiare, që e përçojnë stresin financiar në disa segmente të tregjeve financiare;

b) situata e përmendur në shkronjën “a”, jo vetëm që sjell rritje të paqëndrueshmërisë së çmimeve për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar të bankës ose rritje të ndjeshme të kostos për bankën, por, gjithashtu, çon në mbylljen e plotë ose të pjesshme të tregjeve, duke penguar bankën të emetojë këto instrumente në treg;

c) mbyllja e tregut të përmendur në shkronjën “b” vërehet jo vetëm për bankën përkatëse, por edhe për disa banka të tjera;

d) situata e përmendur në shkronjën “a” pengon bankën të emetojë instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar në një vëllim të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e parashikuara në pikën 1;

e) ushtrimi i kompetencës së përcaktuar në pikën 1 çon në efekte negative zinxhir për një pjesë të sektorit bankar, që mund të cenojë stabilitetin financiar.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përsërit çdo muaj vlerësimin për kushtet e pikës 5 së këtij neni për të përcaktuar nëse përjashtimi mund të zbatohet.

7. Kufizimi i pagesës së shpërndarjes të përcaktuar në pikën 1 përlllogaritet duke shumëzuar vlerën e përcaktuar në pikën 8 me faktorin e përcaktuar në pikën 9 të këtij neni. Vlera e përlllogaritur e kufizimit të shpërndarjes mund të zvogëlohet nga secili prej veprimeve të referuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1.

8. Vlera, që do të shumëzohet në përputhje me pikën 7 të këtij neni, përbëhet nga:

a) fitimi ushtrimor i papërfshirë në kapitalin bazë të nivelit të parë, i netuar nga shpërndarja e fitimit ose nga ndonjë pagesë e kryer, sipas veprimeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1; duke shtuar

b) fitimin e fundvitit të papërfshirë në kapitalin bazë të nivelit të parë, të netuar nga shpërndarja e fitimit ose nga ndonjë pagesë e kryer, sipas veprimeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1; duke zbritur

c) çdo taksë apo detyrim tjetër të ngjashëm, që do të duhej të paguhej nëse fitimi i gjeneruar, sipas shkronjave “a” dhe “b”, do të ruhej i plotë.

9. Faktori i përcaktuar në pikën 7 të këtij neni përlllogaritet si më poshtë:

a) në rast se kapitali bazë i nivelit të parë, i cili nuk përdoret për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, i shprehur si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, është brenda kuartilin të parë (kufiri i poshtëm) të kërkesës për shtesën makroprudenciale të përcaktuar, sipas nenit 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, faktori është 0.

b) në rast se kapitali bazë i nivelit të parë, i cili nuk përdoret për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, i shprehur si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, është brenda kuartilin të dytë të kërkesës për shtesën makroprudenciale të përcaktuar, sipas nenit 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, faktori është 0.2.

c) në rast se kapitali bazë i nivelit të parë, i cili nuk përdoret për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, i shprehur si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, është brenda kuartilin të tretë të kërkesës për shtesën makroprudenciale të përcaktuar, sipas nenit 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, faktori është 0.4.

d) në rast se kapitali bazë i nivelit të parë, i cili nuk përdoret për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, i shprehur si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, është brenda kuartil të katërt (kufiri i sipërm) të kërkesës për shtesën makroprudenciale të përcaktuar sipas nenit 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, faktori është 0.6.

10. Kufijtë e poshtëm dhe të sipërm të secilit kuartil të kërkesës për shtesat makroprudenciale llogariten si më poshtë:

a) kufiri i poshtëm i kuartil të katërt = Shtesa makroprudenciale për kapital/4 x $(K_n - 1)$

b) kufiri i sipërm i kuartil të katërt = Shtesa makroprudenciale për kapital/4 x K_n

ku K_n = numri rendor i kuartil të përkatës.

11. Vendimmarrja e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi masat korrektuese të përcaktuara në këtë nen komunikohet me shkrim nga Administratori Përgjegjës për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

KREU IV KËRKESA RAPORTUESE DHE PERIUDHAT E NDËRMJETME

Neni 16

Raportimi mbikëqyrës

1. Banka raporton në Bankën e Shqipërisë 6 muaj pas hyrjes në fuqi të rregullores, treguesit e përcaktuar në formularët e raportimit, të përfshirë në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

2. Frekuenca e raportimit, sipas pikës 1 është tremujore dhe, në rast nevoje, më e shpeshtë sipas kërkesës së Bankës së Shqipërisë.

3. Në rast se ndaj bankës janë zbatuar kompetencat e zhvlerësimit dhe konvertimit, sipas nenit 45, të ligjit nr. 133/2016, dhe/ose instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, sipas nenit 30, të ligjit nr. 133/2016, kërkesat për raportim të përcaktuara në këtë nen zbatohen 12 muaj pas afatit të përfundimit të periudhës 2-vjeçare të përcaktuar në pikën 7, të nenit 17, të kësaj rregulloreje.

4. Banka nuk zbaton kërkesat për raportim, sipas aneksit 1, në rast se plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon likuidimin, sipas procedurave të likuidimit të detyruar.

Neni 17

Zbatimi i kërkesave për periudhën e ndërmjetme dhe për periudhën pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Banka përmbush “kërkesën minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar”, të përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, brenda datës 31 dhjetor 2027.

2. Gjatë periudhës së ndërmjetme nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje deri në afatin përfundimtar, sipas përcaktimit në pikën 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton dhe i komunikon bankës brenda afatit të parashikuar në nenin 29, pika 2 të rregullores “Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, nivelin e ndërmjetëm të “kërkesës minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar”.

3. Niveli i ndërmjetëm i “kërkesës minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar” duhet të sigurojë një përmbushje graduale të nivelit të kërkesës përfundimtare të përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje. Për përcaktimin e nivelit të ndërmjetëm, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr në konsideratë elementet e mëposhtme:

a) zhvillimet në situatën financiare të bankës;

b) modelin e financimit të bankës dhe, në veçanti, varësinë ndaj financimit përmes depozitave dhe emetimit të instrumenteve të borxhit;

c) aksesin në tregjet e kapitalit në lidhje me emetimin e instrumenteve të borxhit; dhe

d) madhësinë e përmbushjes së kërkesës së përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje përmes instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë.

4. Banka përmbush nivelin e ndërmjetëm të “kërkesës minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar” brenda 12 muajve pas komunikimit zyrtar të këtij niveli nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

5. Në përfundim të periudhës së ndërmjetme, “kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar” të bankës është e barabartë me kërkesat e përcaktuara sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.

6. “Kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”, e përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, nuk do të zbatohet për periudhën 2-vjeçare, pasi:

a) Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka zbatuar ndaj bankës instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 133/2016; ose

b) banka, grupi bankar ose aksionari i bankës ka marrë një masë sipas shkronjës “b”, të nenit 21, të ligjit nr. 133/2016, ku instrumentet e kapitalit ose detyrime të tjera janë konvertuar në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë ose kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka zbatuar ndaj bankës kompetencën e zhvlerësimit dhe të konvertimit, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 133/2016, duke rikapitalizuar bankën pa zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

7. Në përfundim të periudhës 2-vjeçare, sipas pikës 6 të këtij neni, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton periudhën e përshtatshme gjatë së cilës banka duhet të përmbushë “Kërkesën minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar”.

8. Vendimi në lidhje me kërkesat e përcaktuara në këtë nen merret dhe komunikohet me shkrim nga Administratori Përgjegjës për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Neni 18

Dispozitë e fundit

Aneksi 1, si dhe shënimet shpjeguese për plotësimin e formularëve bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

ANEKSI NR. 1

FORMULARËT PËR RAPORTIMIN E INFORMACIONIT CILËSOR TË BASHKËLIDHUR ME KËTË RREGULLORE DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

Formulari 1. Treguesit kryesorë për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

Rreshti	Zëri	Lek	Valutë	Totali
		1	2	3
1	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik			
2	Totali i kapitalit rregullator dhe detyrimeve			
3	Kapitali rregullator dhe detyrimet e pranuar			
3/1	Nga të cilat: kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura			
3/2	Nga të cilat: detyrime që rregullohen nga ligji i një vendi të huaj			

3/3	Nga të cilat: detyrime që përmbajnë një klauzolë kontraktuale për njohjen e kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit, në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 133/2016			
4	Detyrime të tjera që mund të përdoren për rikapitalizim nga brenda			
4/1	Nga të cilat: detyrime që rregullohen nga ligji i një vendi të huaj			
4/11	maturimi i mbetur < 1 vit			
4/12	maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet			
4/13	maturimi i mbetur >= 2 vjet			
4/2	Nga të cilat: detyrime që përmbajnë një klauzolë kontraktuale për njohjen e kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 133/2016			
4/21	maturimi i mbetur < 1 vit			
4/22	maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet			
4/23	maturimi i mbetur >= 2 vjet			
4/3	Detyrime të tjera			
4/31	maturimi i mbetur < 1 vit			
4/32	maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet			
4/33	maturimi i mbetur >= 2 vjet			
5	Kapitali rregullator dhe detyrimet e pranuar si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezik			
5/1	Nga e cila: kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura			
6	Kapitali rregullator dhe detyrimet e pranuar si përqindje e "totalit të detyrimeve dhe kapitalit rregullator"			
6/1	Nga e cila: kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura			
	Kërkesat rregullative			
7	<i>"Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar"</i>			
8	<i>"Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar"</i> e shprehur si përqindje e totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik			
8/1	Nga të cilat: pjesa që plotësohet nga kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura			
9	<i>"Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar"</i> e shprehur si përqindje e "të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit"			
9/1	Nga të cilat: pjesa që plotësohet nga kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura			

Formulari 2. Struktura e detyrimeve të pranuar

Rreshti	Zëri	Lek	Valutë	Totali
		1	2	3
1	DETYRIMET E PRANUARA			
2	Depozitat e pasigurueshme me maturim > 1 vit			
2/1	nga të cilat: maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet			
2/2	nga të cilat: maturimi i mbetur >= 2 vjet			
3	Detyrime të siguruar, të pakolateralizuara			
3/1	maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet			
3/2	maturimi i mbetur >= 2 vjet			
4	Dëftesat e strukturuar			
4/1	maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet			
4/2	maturimi i mbetur >= 2 vjet			
5	Detyrime senior (me përparësi të lartë) të pakoletarizuara			

5/1	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			
5/2	maturimi i mbetur ≥ 2 vjet			
6	Detyrime senior jopreferenciale			
6/1	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			
6/2	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			
7	Borxh i varur (jo pjesë e kapitalit rregullator)			
7/1	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			
7/2	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			
8	Detyrime të tjera të pranuar për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”			
8/1	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			
8/2	maturimi i mbetur ≥ 1 vit < 2 vjet			

Formulari 3. Kapaciteti dhe përbërja e “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

Rreshti	Zëri	Lek	Valutë	Totali
		1	2	3
1	Kërkesa minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuar (sipas nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 133/2016)			
2	Kapitali rregullator			
2/1	Kapitali bazë i nivelit të parë (KBN1)			
2/2	Kapitali shtesë i nivelit të parë			
2/3	Kapitali i nivelit të dytë			
3	Detyrime të pranuar			
3/1	Detyrime të pranuar të nënrenditura ndaj detyrimeve të përjashtuara			
3/2	Zëra të detyrimeve të pranuar të emetuara përpara datës 30 tetor 2021			
3/3	Instrumente të kapitalit të nivelit të dytë me maturitet të mbetur të paktën 1 vit			
3/4	Detyrime të pranuar jo të nënrenditura ndaj detyrimeve të përjashtuara			
3/5	Zëra të detyrimeve të pranuar të emetuara përpara datës 30 tetor 2021			
ZËRA MEMORANDUMI				
3	KBN1 (%) i disponueshëm pas plotësimit të kërkesave rregullative			
4	Ekspozimet në detyrimet e pranuar të bankave të tjera			
4/11	Ekspozimet në detyrimet e pranuar të bankave me rëndësi sistemike			
4/12	Nga të cilat: të nënrenditura			
4/13	Ekspozimet në detyrimet e pranuar të bankave të tjera			
4/14	Nga të cilat: të nënrenditura			

Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve në aneksin nr. 1 që përmban informacionin cilësor dhe sasior të bashkëlidhur me këtë rregullore

Formulari 1. Treguesit kryesorë për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”

A. Shënime të përgjithshme

Ky formular kërkon informacion mbi vlerën e instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar si dhe treguesit në përqindje të llogaritur sipas kërkesave të ligjit nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë” dhe të kësaj rregulloreje. Raportimi i formularëve është në njësi monetare (Lek) – përveçse kur përcaktohet ndryshe në shënimet përkatëse. Për instrumentet e emetuara në monedhë të huaj, raportimi do të bëhet në monedhën Lek.

B. Udhëzime në lidhje me zërat specifikë

Rreshti	Referenca ligjore dhe udhëzime
1	<u>Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik</u> Sipas nenit 6, të rregullores nr. 48/2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, e ndryshuar.
2	<u>Totali i kapitalit rregullator dhe detyrimeve</u> Shuma e të gjitha detyrimeve të bankës së bashku me shumën e kapitalit rregullator, duke përfshirë derivativët, pas zbatimit të rregullave prudenciale të netimit.
3	<u>Kapitali rregullator dhe detyrimet e pranuar</u> Vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar që përfshihen në “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” do të llogaritet si shuma e: i. kapitalit rregullator sipas përcaktimit në nenin 5 të rregullores “Për kapitalin rregullator”; ii. detyrimeve të pranuar të përfshira në vlerën e “kërkesës minimale për kapital rregullator dhe detyrimet e pranuar” që përbushin kushtet sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
3/1	<u>Nga të cilat: kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura</u> Vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar do të raportohen si shuma e: i. kapitalit rregullator siç përcaktohen në nenin 5 të rregullores “Për kapitalin rregullator”; ii. detyrimet e pranuar të përfshira në vlerën e “kërkesës minimale për kapital rregullator dhe detyrimet e pranuar” që përbushin kushtet sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”, të cilat janë të nënrenditura sipas përcaktimit në nenin 9, pika 1, të kësaj rregulloreje.
3/2	<u>Nga të cilat: detyrime që rregullohen nga ligji i vendit të huaj</u> Vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar që rregullohen nga ligji i një vendi të huaj në kuptim të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.
3/3	<u>Nga të cilat: detyrime që përmbajnë një klauzolë kontraktuale për zhvlerësimin dhe konvertimin në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 133/2016</u> Vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar që rregullohen nga ligji i një vendi të huaj dhe që përmbajnë një klauzolë kontraktuale për njohjen e kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit, siç përcaktohet në nenin 42, të ligjit nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.
4	<u>Detyrime të tjera që mund të përdoren për rikapitalizimin nga brenda</u> Vlera e detyrimeve që mund të përdoren për rikapitalizimin nga brenda, siç përcaktohet në nenin 4, pika 13 të ligjit nr. 133/2016, ku përfshihen detyrimet dhe instrumentet e kapitalit, të cilat nuk kategorizohen si instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, kapitalit shtesë të nivelit të parë ose kapitalit të nivelit të dytë të një banke dhe që nuk janë përjashtuar nga objekti i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda në bazë të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 133/2016. Në këtë pjesë raportohen vetëm detyrimet, të cilat janë të pranuar, sipas përkufizimit në nenin 4, pika 13 të ligjit nr. 133/2016, por nuk janë klasifikuar si pjesë e “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
4/1	<u>Nga të cilat: detyrime që rregullohen nga ligji i vendit të huaj</u> Vlera e detyrimeve të tjera që mund të përdoren për rikapitalizim nga brenda dhe rregullohen nga ligji i një vendi tjetër në kuptim të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016.
4/11	maturimi i mbetur <1 vit
4/12	maturimi i mbetur >=1 vit<2 vjet
4/13	maturimi i mbetur >=2 vjet
4/2	<u>Nga të cilat: detyrime që përmbajnë një klauzolë për zhvlerësimin dhe konvertimin në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 133/2016</u> Vlera e detyrimeve që mund të përdoren për rikapitalizimin nga brenda të rregulluara me ligjin e një vendi tjetër dhe që përmbajnë një klauzolë zhvlerësimi dhe konvertimi, siç përcaktohet në nenin 42 të ligjit nr. 133/2016.
	maturimi i mbetur <1 vit
	maturimi i mbetur >=1 vit<2 vjet
	maturimi i mbetur >=2 vjet
4/3	<u>Të tjera</u> Detyrime të tjera që mund të përdoren për rikapitalizimin nga brenda që nuk janë të përfshira në zërat e mësipërm.
4/31	maturimi i mbetur <1 vit
4/32	maturimi i mbetur >=1 vit<2 vjet
4/33	maturimi i mbetur >=2 vjet
5	<u>Kapitali rregullator dhe detyrimet e pranuar si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezik</u> Për qëllim të këtij rreshti, vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar që raportohen në rreshtin 3, shprehet si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezik.

5/1	<u>Nga të cilat: kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura</u> Për qëllim të këtij rreshti, vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar të nënrenditura që raportohen në rreshtin 3/1, shprehet si përqindje e ekspozimeve të ponderuara me rrezik.
6	<u>Kapitali rregullator dhe detyrimet e pranuar si përqindje e totalit të detyrimeve dhe kapitalit rregullator</u> Për qëllim të këtij rreshti, shumta e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar të raportuara në rreshtin 3 shprehet si përqindje e “të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës”, në përputhje me nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 133/2016. Në kuptim të kësaj pike, detyrimet që rrjedhin nga transaksionet me produkte derivative përfshihen në totalin e detyrimeve, duke njohur plotësisht të drejtat për kompensim të palës tjetër.
6/1	<u>Nga të cilat: kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura</u> Për qëllim të këtij rreshti, vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar të nënrenditura që raportohen në rreshtin 3/1, shprehet si përqindje e “të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës” llogaritur në përputhje me nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 133/2016. Në kuptim të kësaj pike, detyrimet që rrjedhin nga transaksionet me produkte derivative përfshihen në totalin e detyrimeve, duke njohur plotësisht të drejtat për kompensim të palës tjetër.
7-9	<u>Kërkesat rregullative</u>
7	<u>“Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”</u>
8	<u>“Kërkesa minimale për kapital dhe detyrimet e pranuar” e shprehur si përqindje e totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik</u> “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar” siç përcaktohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në zbatim të nenit 5 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar” e shprehur si përqindje e totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik.
8/1	<u>Nga të cilat: pjesa që plotësohet nga kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura</u> Për qëllim të këtij rreshti, vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar të nënrenditura që raportohen në rreshtin 3/1, shprehet si përqindje e totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik.
9	<u>“Kërkesa minimale për kapital dhe detyrimet e pranuar” e shprehur si përqindje e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar</u> “Kërkesa minimale për kapital dhe detyrimet e pranuar” siç përcaktohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016, i shprehur si përqindje e të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës”.
9/1	<u>Nga të cilat: pjesa që plotësohet nga kapitali rregullator dhe detyrimet e nënrenditura</u> Për qëllim të këtij rreshti, vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar të nënrenditura që raportohen në rreshtin 3/1, shprehet si përqindje e “të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës”

Formulari 2. Struktura e detyrimeve të pranuar

A. Shënime të përgjithshme

Ky formular kërkon informacion mbi strukturën e financimit të detyrimeve të pranuar të subjekteve që i nënshtrohen plotësisht të “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”. Detyrimet e pranuar ndahen sipas llojit të detyrimit dhe maturimit.

Për instrumentet e emetuara në monedhë të huaj, raportimi bëhet në monedhën lek.

B. Udhëzime në lidhje me zërat specifikë

Rreshti	Referenca ligjore dhe udhëzimet
1	<u>Detyrimet e pranuar</u>
2	<u>Depozitat e pasigurueshme me maturim > 1 vit</u> Depozitat e pasigurueshme, ku nuk përfshihen depozitat për individë, tregtarë dhe shoqëri tregtare
2/1	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet</u>
2/2	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 2 vjet</u>
3	<u>Detyrime të pagarantuara</u> Detyrimet të pakolaterizuara, që janë të pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”
3/1	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet</u>
3/2	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 2 vjet</u>
4	<u>Dëftesat e strukturuara</u> Dëftesat e strukturuara përkufizohen si instrumente të borxhit që përmbajnë një përbërës derivativ, kthimi i të cilit varet nga një titull ose indeks (publik ose me ofertë, si aksione ose obligacione, me norma fikse kthimi ose të kredisë, të monedhave, mallrave kryesore etj.). Dëftesat e strukturuara nuk përfshijnë instrumente të borxhit që mbartin vetëm opsionin e shitjes ose të blerjes p.sh. vlera e instrumentit nuk varet nga ndonjë element përbërës i derivativit që e mbulon. Këtu do të raportohen dëftesa të strukturuara, që janë klasifikuar si të pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
4/1	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet</u>

4/2	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 2 vjet</u>
5	<u>Detyrime senior (me përparësi të lartë) të pakolateralizuara</u> Detyrime senior (me përparësi të lartë) të pasiguruara
5/1	<u>Nga të cilat: me maturitet të mbetur >= 1 vit dhe < 2 vjet</u>
5/2	<u>Nga të cilat: me maturitet të mbetur >= 2 vjet</u>
6	<u>Detyrime (senior) jopreferenciale</u> Detyrime senior jopreferenciale, që janë të pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
6/1	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet</u>
6/2	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 2 vjet</u>
7	<u>Borxh i varur (jo pjesë e kapitalit rregullator)</u> Detyrimet e borxhit të varur, duke përfshirë pjesën e përfshirë në kapitalin rregullator, sipas specifikave të neneve 30, 31 të rregullores nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator”, e ndryshuar.
7/1	<u>Nga të cilat: me maturitet të mbetur >= 1 vit dhe < 2 vjet</u>
7/2	<u>Nga të cilat: me maturitet të mbetur >= 2 vjet</u>
8	<u>Detyrime të tjera të pranuar për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar” >= 1 vit</u> Çdo instrument tjetër që është i pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
8/1	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 1 vit < 2 vjet</u>
8/2	<u>Nga të cilat: maturimi i mbetur >= 2 vjet</u>

Formulari 3. Kapaciteti dhe përbërja e “kërkesës minimale për kapital dhe detyrimet e pranuar”

A. Shënime të përgjithshme

Ky formular ofron detaje të mëtejshme mbi përbërjen e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar.

Për instrumentet e emtuara në monedhë të huaj, raportimi bëhet në monedhën lek.

B. Udhëzime në lidhje me zërat specifikë

Rreshti	Referenca ligjore dhe udhëzime
1	<u>KËRKESA MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIMET E PRANUARA</u> Vlera e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar do të raportohen si shuma e: i. kapitalit rregullator siç përcaktohet në nenin 5 të rregullores nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator të bankës”, e ndryshuar; ii. detyrimet e pranuar të përfshira në vlerën e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
2	<u>Kapitali rregullator</u> Sipas nenit 5 të rregullores nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator të bankës”, e ndryshuar
2/1	<u>Kapitali bazë i nivelit të parë</u> Sipas nenit 6 të rregullores nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator të bankës”, e ndryshuar
2/2	<u>Kapitali shtesë i nivelit të parë</u> Sipas nenit 21 të rregullores nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator të bankës”, e ndryshuar
2/3	<u>Kapitali i nivelit të dytë</u> Sipas nenit 30 të rregullores nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator të bankës”, e ndryshuar
3	<u>Detyrimet e pranuar</u> Detyrimet e pranuar të përfshira në vlerën e “kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar” që plotësojnë kushtet sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
3/1	<u>Detyrime të pranuar të nënrenditura ndaj detyrimeve të përfshira</u> Detyrimet e pranuar të përfshira në vlerën e “kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar”, të cilat janë instrumente të pranuar të nënrenditura sipas përcaktimit në nenin 9, pika 1, të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
3/2	<u>Zëra të detyrimeve të pranuar të emtuara para datës 31 tetor 2021</u> Detyrime të pranuar, që plotësojnë kushtet e mëposhtme: - janë emtuar para datës 31 tetor 2021, - janë instrumente të pranuar të nënrenditura siç përcaktohen në nenin 9, pika 1, të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.
3/3	<u>Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë me maturim të mbetur të paktën një vit</u>

	Ky rresht përfshin pjesën e amortizuar të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë, kur maturimi i mbetur është më i madh se një vit. Në këtë rresht raportohet vetëm shuma që nuk njihet në kapitalin rregullator, por plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë, sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuarë”
3/4	<u>Detyrime të pranuarë jo të nënrenditura ndaj detyrimeve të përjashtuara</u> Detyrimet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuarë”, të cilat nuk janë plotësisht të nënrenditura ndaj detyrimeve të përjashtuara të përcaktuara në nenin 31, pika 2 të ligjit nr. 133/2016.
3/5	<u>Zëra të detyrimeve të pranuarë të emetuara para datës 31 tetor 2021</u> Detyrime të pranuarë që plotësojnë kushtet e mëposhtme: - janë emetuar para datës 31 tetor 2021; - janë instrumente të pranuarë të nënrenditura siç përcaktohen në nenin 9, pika 1, të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuarë”.
	<u>ZËRA MEMORANDUMI</u>
4	<u>Kapitali bazë i nivelit të parë KBN1 (%) i disponueshëm pas plotësimit të kërkesave rregullative</u> Shuma e kapitalit bazë të nivelit të parë, e barabartë me zero ose pozitive, e disponueshme pasi të jetë përmbushur: a) secili nga kufijtë e treguesve të kapitalit rregullator (të përcaktuar në nenin 42 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”; b) “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuarë” në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 133/2016. Kapitali bazë i nivelit të parë do të shprehet në terma të ekspozimeve të ponderuara me rrezik
4/1	<u>Ekspozimet në detyrimet e pranuarë të bankave të tjera</u>
4/11	<u>Ekspozimet në detyrimet e pranuarë të bankave me rëndësi sistemike</u> Shuma e ekspozimeve në instrumente të detyrimeve të pranuarë që përmbushin kushtet sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuarë”, të emetuara nga një bankë sistemike.
4/12	<u>Nga të cilat: të nënrenditura</u>
4/13	<u>Investimet në detyrimet e pranuarë të bankave të tjera</u> Shuma e ekspozimeve në instrumente të detyrimeve të pranuarë që përmbushin kushtet sipas neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuarë”, të emetuara nga bankat që nuk janë klasifikuar si banka me rëndësi sistemike
4/14	<u>Nga të cilat: të nënrenditura</u>

Formulari 4. Parashikimi i nevojave për financimin e “kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuarë”

a) Shënime të përgjithshme

Ky formular synon të parashikojë nevojën 2-vjeçare të bankës për financim të instrumenteve të pranuarë për qëllime të përmbushjes së “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuarë”, duke vlerësuar flukset (hyrëse dhe dalëse) gjatë secilit tremujor.

1.1.1 Udhëzime në lidhje me zërat specifike

Rreshti	Referenca ligjore dhe udhëzimet
1	<u>DETYRIMET E PRANUARË</u>
2	<u>Depozitat e pasigurueshme me maturim > 1 vit</u> Depozitat e pasigurueshme, të cilat nuk nuk zotërohen nga individë, tregtarë dhe shoqëri tregtare.
2/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
2/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
3	<u>Detyrime të siguruara, të pakolateralizuara</u> Detyrimet e siguruara për të cilat vlera e detyrimit është më e lartë se vlera e kolateralit, barrës siguroese apo aktivitet të vendosur si kolateral, që janë të pranuarë për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuarë”
3/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
3/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
4	<u>Dëftesat e strukturuara</u>

	Këtu do të raportohen dëftesat e siguruara që klasifikohen si të pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”.
4/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
4/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
5	<u>Detyrime senior (me përparësi të lartë) të pakolateralizuara</u> Detyrime senior (me përparësi të lartë) të pasiguruara
5/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
5/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
6	<u>Detyrime (senior) jopreferenciale</u> Detyrime senior jopreferenciale, që janë të pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”.
6/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
6/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
7	<u>Detyrime të nënrenditura</u> Detyrime që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 9, pika 1 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”.
7/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
7/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
8	<u>Detyrime të tjera të pranuar për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” > = 1 vit</u> Për çdo instrument tjetër që është i pranuar për qëllimet e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”.
8/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Detyrime që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
8/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Detyrime që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
9	<u>KAPITALI RREGULLATOR TOTAL I PRANUESHËM PËR “KËRKESËN MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIMET E PRANUARA”</u> Sipas nenit 5 të rregullores “Për kapitalin rregullator”
10	<u>Kapitali bazë i nivelit të parë</u> Sipas nenit 6, të rregullores “Për kapitalin rregullator”.
10/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Zëra që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
10/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Zëra që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
11	<u>Kapitali shtesë i nivelit të parë</u> Sipas nenit 21 të rregullores “Për kapitalin rregullator”
11/1	<u>Fluksi dalës bruto</u> Zëra që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
11/2	<u>Fluksi hyrës bruto</u> Zëra që gjatë vitit plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
12	<u>Borxh i varur, i pranueshëm për qëllime të “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”</u>

	Sipas nenit 30 të rregullores “Për kapitalin rregullator”.
12/1	Fluksi dalës bruto Zëra që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
12/2	Fluksi hyrës bruto Zëra që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
13	Totali i kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar
13/1	Fluksi dalës bruto Zëra që nuk plotësojnë më kriterin e përfshirjes në këtë klasë.
13/2	Fluksi hyrës bruto Zëra që plotësojnë kriterin e përfshirjes në këtë klasë.

Formulari 5. Renditja e kreditorëve

a) Shënime të përgjithshme

Kjo tabelë trajton të gjithë zërat e kapitalit rregullator dhe detyrimeve që renditen *pari passu* (në rang të njëjtë) ose në një rang më të ulët ndaj çdo instrumenti të përfshirë në shumën e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar për qëllimin e “kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar”.

Renditja paraqitet nga më e ulëta (*junior*) tek më e larta (*senior*). Rreshtat për renditjen do të shtohen deri sa të jenë raportuar të gjitha instrumentet, duke filluar nga instrumenti i pranuar i renditur më lart (më *senior*) dhe të gjitha detyrimet që renditen *pari passu* me të.

b) Udhëzime në lidhje me zërat specifikë

Kolonat	Referenca ligjore dhe udhëzimet
1	Radha e shlyerjes së detyrimeve në likuidim të detyruar Renditja në hierarkinë e kreditorëve të subjektit raportues, duke filluar me renditjen më të ulët (<i>junior</i>), të klasifikuar në përputhje me nenin 121, të ligjit nr. 9662/2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2	Lloji i kreditorit Lloji i kreditorit i identifikuar si bankë, institucion financiar, individ, tregtar dhe shoqëri tregtare.
3	Detyrimet dhe kapitali rregullator Shuma e kapitalit rregullator, detyrimeve të pranuar dhe detyrimeve të nënrenditura, të raportuara sipas renditjes së treguar në kolonën 1. Këtu do të përfshihen, gjithashtu, edhe detyrimet e përjashtuara nga rikapitalizimi nga brenda.
4	Nga të cilat: detyrimet e përjashtuara Detyrimet e përjashtuara, sipas nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 133/2016.
5	Detyrimet dhe kapitali rregullator pas përjashtimeve Shuma e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar, siç raportohet në kolonën 3, pas zbritjes së detyrimeve të raportuara në kolonën 4.
6	Nga të cilat: kapital rregullator dhe detyrime të pranuar për plotësimin e kërkesës së neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” Shuma e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar për qëllimin e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”
7-10	Nga të cilat: me maturim të mbetur prej: Shuma e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar për qëllimin e neneve 8–10 të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, siç raportohet në kolonën 6, do të ndahet sipas maturimit të mbetur të instrumenteve dhe zërave të ndryshëm. Instrumentet dhe zërat me natyrë të përhershme, nuk do të merren parasysh në këtë ndarje, por raportohen veçmas në kolonën 11.
7	≥ 1 vit < 2 vjet
8	≥ 2 vjet < 5 vjet
9	≥ 5 vjet < 10 vjet
10	≥ 10 vjet
11	Nga të cilat: instrumente pa maturim (<i>perpetual</i>)

Formulari 6. Instrumentet që rregullohen nga ligji i një vendi të huaj

A. Shënime të përgjithshme

Tabela 3 parashikon raportimin e instrumenteve që klasifikohen si kapital rregullator dhe detyrime të pranuar për qëllimet e “kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar”, në nivel kontrate. Në këtë tabelë raportohen vetëm instrumentet që rregullohen nga ligji i një vendi tjetër.

Në lidhje me detyrimet e pranuar që nuk janë të nënrenditura ndaj detyrimeve të përjashtuara sipas nenit 31, pika 2 të ligjit nr. 133/2016, subjekti raporton vetëm instrumente financiare të negociueshme, me përjashtim të kredive dhe depozitave.

Kombinimi i kolonave 2 (Kodi i subjektit emetues) dhe kolona 4 (kodi identifikues i kontratës) përbën një identifikues të rreshtit, i cili duhet të jetë unik për secilin rresht të raportuar në tabelë.

B. Udhëzime në lidhje me zërat specifike

Kolonat	Referenca ligjore dhe udhëzime
1-3	Subjekti emetues
1	Emri Emri i subjektit që ka emetuar instrumentin e kapitalit rregullator ose instrumentin e detyrimeve të pranuar.
2	Kodi identifikues i subjektit Kodi i subjektit që ka emetuar instrumentin e kapitalit rregullator ose instrumentin e detyrimeve të pranuar. Ky element është pjesë e identifikuesit unik të rreshtit.
3	Lloji i kodit Lloji i kodit të raportuar në kolonën 2, përfshin një nga kategoritë e mëposhtme: - Kodi LEI - Kodi MFI - Lloj tjetër i kodit
4	Kodi identifikues i kontratës Kodi identifikues i kontratës së instrumentit, i tillë si CUSIP, ISIN ose <i>Bloomberg</i> në rastin e vendosjeve. Ky element është pjesë e identifikuesit unik të rreshtit.
5	Legjislacioni që rregullon instrumentin (vendi i huaj) Duhet të raportohet vendi i huaj, ligji i të cilit rregullon kontratën, ose pjesë të kontratës.
6	Njohja kontraktuale e kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit Tregohet nëse kontrata përmban kushtet e kontratës të përmendura në nenin 42, të ligjit nr. 133/2016
7-8	Trajtimi rregullator
7	Lloji i kapitalit rregullator ose detyrimeve të pranuar Lloji i kapitalit rregullator ose detyrimeve të pranuar, për të cilat instrumenti klasifikohet në datën e referencës. Në këtë rast do të merren në konsideratë dispozitat kalimtare për pranueshmërinë e instrumenteve. Instrumentet që klasifikohen për t'u përfshirë në zëra të ndryshëm, do të raportohen vetëm një herë në zërin e zbatueshëm të kapitalit. Lloji i kapitalit rregullator ose detyrimeve të pranuar do të jetë një nga sa vijon: - kapitali bazë i nivelit të parë; - kapitali shtesë i nivelit të parë; - kapitali i nivelit të dytë; - detyrimet e pranuar.
8	Lloji i instrumentit Lloji i instrumentit që do të specifikohet varet nga ligji, sipas të cilit është emetuar.
9	Shuma Shuma e njohur në kapitalin rregullator ose detyrimet e pranuar raportohet, duke marrë parasysh nivelin dhe zërin fillestar të raportimit të instrumentit. Shuma do të jetë shuma përkatëse në datën e referencës. Në rast të instrumenteve që kualifikohen pjesërisht për dy klasa të ndryshme të kapitalit rregullator ose të detyrimeve të pranuar, instrumenti do të raportohet për të pasqyruar shumat e caktuara për secilën klasë.
10	Renditja në radhën e pretendimeve (likuidimi i detyruar) Këtu do të specifikohet renditja e instrumentit në procedurat e likuidimit të detyruar. Duhet të përbëhet nga dy shkronja: kodi ISO i vendit, ligji i të cilit rregullon renditjen e kontratës, dhe radha përkatëse në renditjen kreditore të likuidimit të detyruar. Renditja kreditore në likuidimin e detyruar përcaktohet në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 9662/2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
11	Garancia e instrumentit Këtu do të specifikohet nëse instrumenti është i garantuar me anë të një marrëveshjeje të vlefshme garancie.
12	Emri i garantorit Këtu duhet të përcaktohet emri i subjektit garantues të instrumentit, në rast se ka.
13	I konvertueshëm Këtu duhet të përcaktohet nëse instrumenti mbart të drejtën e konvertimit në një instrument tjetër.
14	Raporti i konvertimit Përfshin raportin e konvertimit të instrumentit fillestar në instrumentin/et e krijuar pas ushtrimit të së drejtës së konvertimit.
15	Maturimi Maturimi i instrumentit raportohet në formatin vijues: dd.mm.vvvv.

	Në rast të instrumenteve pa afat maturimi (<i>perpetual</i>), qeliza lihet e paplotësuar.
16	<p><u>Data e thirrjes së parë (<i>first call</i>)</u></p> <p>Kur emetuesi mund të ushtrojë një opsjon thirrje (<i>call</i>), do të raportohet data e parë në të cilën mund të ushtrohet opsioni i thirrjes <i>call</i>. Nëse data e opsionit të thirrjes ka ndodhur para datës së referencës, ajo datë do të raportohet nëse opsioni është ende i ushtrueshëm. Nëse nuk është më e ushtrueshme, do të raportohet data tjetër në të cilën do të ushtrohet opsioni i thirrjes (<i>call</i>).</p> <p>Në rast të opsioneve të thirrjes të emetuesit me një datë të specifikuar ushtrimi ose opsioni thirrje (<i>call</i>) të shkaktuar nga ngjarje specifike, do të raportohet data e opsionit të thirrjes (<i>call</i>) të mundshëm e parashikuar në mënyrë konservative.</p>
17	<p><u>Opsioni i thirrjes rregullatore (<i>regulatory call</i>) (Po/Jo)</u></p> <p>Nëse emetuesi ka të drejtën e ushtrimit të një opsioni thirrjeje (<i>call</i>), të ushtrueshëm pas ndodhjes së një ngjarjeje rregullatore, që ndikon në pranueshmërinë e kontratës për “kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”</p>